

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA
KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-168/13

Prishtinë,
19 February 2014

Në çështjen juridike të:

H. Ç.

Mitrovicë

Pala ankuese

kundër

R.M.

Mitrovicë

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D-R-173-2012 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA00643), të datës 4 tetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 19 shkurt 2014, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Hadije Ç.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D-R-173-2012 (lidhur me shkresat e lëndës të regjistruara në KPA me numër KPA00643), të datës 24 tetor 2012.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 29 mars 2007 R. M.ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar të drejtën pronësore e 1/2 pjesës ideale të parcelës nr. 1572 me sipërfaqe të përgjithshme prej 0,0147 ha siç regjistrohet në fletën poseduese nr. 1476 në Mitrovicë. Adresa e pronës është gjindet Bore Vukmirovica nr. 45. Kërkesën ajo e ka bërë në emër të nënës së saj L. M.
2. Kërkesa i referohet vendimit T.nr. 149/06, të marrë nga Gjykata Komunale e Mitrovicës me datë 25 korrik 2006 ku thuhet se L. M. ka trashëguar pronën nga xhaxhai i saj D. J. i cili gjithashtu ishte i gjyshi i R. M.. Sipas kërkesës, R. M. ka jetuar me nënën e saj në këtë pronë gjer më 1 Qershor 1999 kur ato ikën për shkak të konfliktit të armatosur në 1998/1999. Gjithashtu, në bazë të kërkesës, prona ishte uzurpuar nga H. Ç.
3. Së bashku me kërkesën R. M ka paraqitur aktgjykimin e lëshuar nga Gjykata Komunale e Mitrovicës në lëndën C.nr. 441/2003 ku ishte vendosur se A. Ç. ishte pronare e pronës së kontestuar. A. Ç. ishte e ëma e H. Ç. Në këtë lëndë si palë ishin A. Ç. si paditëse dhe D. J. si i paditur. Për shkak se adresa e D. J. nuk ishte e njohur, një avokat si përfaqësues i përkohshëm ishte emëruar për të në pajtim me nenin 84 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, RSFJ, 4/1977 (37) (LPK 1977).
4. D. J. vdiq më 6 qershor 1980. Gjykata Komunale e Mitrovicës nuk ka qenë në dijeni lidhur me këtë fakt kur ka shqyrtuar lëndën C.nr. 441/2003 në mungesë të J.
5. H. Ç. iu ka përgjigjur kërkesës më 12 janar 2011. Në përgjigje ajo deklaroi se prona ishte blerë nga vëllai i saj, E. Ç. , i cili kishte transferuar pronën në emrin e saj , dhe se për këtë arsye ajo kishte të drejtën ligjore mbi pronën.
6. Më 3 prill 2007, Liljana Milosavljeviç ngriti një padi kundër H. Ç në Gjykatën Komunale të Mitrovicës duke pretenduar të jetë pronare e 2/4 së pronës së kontestuar. Gjykata Komunale e Mitrovicës nuk ka filluar procedurat në këtë rast.
7. Më 24 tetor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) e ka pranuar kërkesën me vendimin grupor. Rasti është arsyetuar në paragrafin 19 deri 22 në këtë vendim. Para marrjes së vendimit, KKPK-ja ka mbajtur një seancë dëgjimore verbale lidhur me rastin më 1 tetor 2012. KKPK-ja ka konstatuar se aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Mitrovicës nuk ishte një provë e mjaftueshme për faktin se A.Ç. i është

pranuar e drejta e pronës që është objekt i kërkesës. Nuk ka prova në shkresat e lëndës se D. J. e kishte shitur pronën në vitin 1973. Mbesa dhe stërmbesa e tij kishin jetuar në pronë deri në vitin 1999.

8. Vendimi i është dorëzuar H Ç më 20 maj 2013. Ajo ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme më 13 qershor 2013 . R.M. iu ka përgjigjur ankesës më 30 shtator 2013. Gjykata Supreme ka pranuar dosjen e lëndës me 10 janar 2014.

Pretendimet e palëve

9. H. Ç. pretendon se vendimi i KKKPK-së është i bazuar në një gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike.

10. KKKPK-ja ka konsideruar në mënyrë të gabuar se Renata Milosavljeviq ka fituar të drejtën e pronësisë mbi pronën e kontestuar. Kur Gjykata Komunale në Mitrovicë ka lëshuar vendimin e saj lidhur me lëndën T.nr. 149 / 06 më 25 korrik 2006 duke shpallur Liljana Milosavljeviçin si trashëgimtare ligjore pas D. J. , më shumë se 20 vjet kishin kaluar dhe gjatë kësaj kohe ajo e kishte pranuar gjendjen faktike se ajo nuk është trashëgimtare pas J. Gjatë kësaj kohe H. Ç. ishte “poseduese me mirëbesim” e pronës sipas nenit 28 paragrafi 4 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike.

11. Në aktgjykimin e marrë nga Gjykata Komunale në Mitrovicë, më 21 prill të vitit 2004 është konstatuar se D. J. ia ka shitur pronën e kontestuar I. H., dhe se H.i në vitin 1975 ia ka shitur pronën nënës së palës ankuese A Ç. KKKPK-ja e ka injoruar këtë aktgjykim, i cili ishte i formës së prerë. Kjo është për t'u habitur gjithashtu për faktin se KKKPK-ja e ka konstatuar si të ligjshëm vendimin mbi trashëgiminë të datës 25 korrik 2006, gjersa në të njëjtën kohë ka konstatuar se aktgjykimi i lëshuar nga e njëjta gjykatë më 21 prill 2004 është i paligjshëm.

12. H. Ç. pretendon se avokati i L. M. tani punon për AKP-në dhe ka punuar që të shpall atë si pronare, por pa sukses.

13 . H. Ç. propozon që Gjykata Supreme duhet ta anulojë vendimin e KKKPK-së dhe lënda të kthehet në KKKPK për rigjykim.

14. R. M. pretendon se vendimi i lëshuar nga KKKPK-ja është i saktë. Ai është i bazuar në provat përkatëse, si dhe në listën poseduese nr . 1474.

Arsyetim ligjor

15. Ankesa është e pranueshme, sepse ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh të paraparë me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (Ligji).

16. Për shkak se Gjykata Komunale e Mitrovicës ka nxjerrë një aktgjykimin i cili i referohet kontestit mes palëve, prandaj kjo Gjykatë duhet të zgjidhë nëse ekziston *res judicata*.

17. Gjykata Supreme konstaton se aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Mitrovicë i datës 21 prill 2004 nuk ka vendosur *res judicata* lidhur me rastin për dy arsye.

18. Së pari padia është ngritur kundër Đ. J. në vitin 2003, në një kohë kur ai ishte i vdekur që nga 6 qershor 1980. Sipas nenit 77, paragrafi i parë i LPK 1977 palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik ose juridik . Në bazë të nenit 82 të po këtij ligji, gjykata *ex officio* kujdeset që pala që parqitet si palë a mund të jetë palë në procedurë. Një person i vdekur nuk mund të jetë palë në procedurë. Ky aktgjykim është i pavlefshëm sepse pala e paditur nuk ka ekzistuar, përkatësisht është i vdekur.

19. Së dyti , aktgjykimi është bërë pas një procedure të parashikuar nga neni 84 i LPK 1977, ku është emëruar një përfaqësues i përkohshëm për Đ. J.. Gjersa gjykata ka ndjekur një procedurë e cila ishte në pajtim me LPK 1977, ajo nuk ka ofruar një gjykim të drejtë për të paditurin Đ. J., dhe ajo nuk ka ofruar asnjë pjesë në procedurat për trashëgimtarin e tij , i cili nuk ishte në dijeni për procedurat. As i padituri e as përfaqësuesi i përkohshëm nuk kanë pasur mundësi të ofrojnë dëshmi apo të paraqesin pretendimet e tyre . Si i e tillë në këtë mënyrë rezulton se aktgjykimi është marrë në kudërshtim me nenin 6 të par. 1 në kohën e duhur, KEDNJ-ës i cili aplikohet sipas nenit 1.3 (b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24

20. Për të dyja këto arsye, Gjykata Supreme konstaton se aktgjykimi i lëshuar nga Gjykata Komunale në Mitrovicë më 21 prill 2004 nuk përfaqëson një gjykim *res judicata* të kontestit.

21. Vendimi i Gjykatës Komunale në Mitrovicë i datës 25 korrik 2006 nuk ka zgjidhur lëndën *res judicata* për shkak se H. Ç. nuk ishte palë në këtë rast, dhe për shkak se ajo nuk i bazon pretendimet e saj në rezultatet e këtij rasti.

22. Më 3 prill 2007, Liljana Milosavljeviç ka paraqitur një padi kundër H. Ç. para Gjykatës Komunale në Mitrovicë, shih paragrafin 6 nw lidhje me faktin qw Gjykata Komunale e Mitrovicës nuk kishte filluar procedurwn nw kwtw lwndw. Kjo kërkesë është paraqitur pasi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 ka hyrë në fuqi më 16 tetor 2006, dhe për këtë arsye kjo Rregullore, është ndryshuar me vonë me Ligjin Nr. 03/L-079. Prandaj, kemi të bëjmë me zbatimin e nenit 18 të kësaj rregulloreje.

23. Prandaj, sikundër KKPK-ja ashtu edhe Gjykata Supreme vendimin e tyre e mbështesin në bazë të vlerësimit të provave të paraqitura dhe vlerësimin e pretendimeve të palëve në këtë çështje juridiko-kontestimore.

24. Në vendimin e saj grupor KPCC/DR-173-2012, KKPK në paragrafin 21 deklaroi se:

" 21. Gjatë seancës së 30-të mbajtur në shtator 2012, Komisioni ka urdhëruar që seanca verbale të mbahet në këtë kërkesë nga një prej anëtarëve të tij në pajtim me nenin 5.4 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të

UNMIK-ut 2007/5 të miratuar me ligjin NR. 03/L-079. Paraqitësja e kërkesës së Renata Miosavljevic dhe e pala përgjegjëse në kërkesë H.Q., si dhe dy dëshmitarë të propozuar nga të dy palët, përkatësisht O.M. dhe Q.M., kanë marrë pjesë në seancën dëgjimore më 1 tetor 2012, në zyrat e AKP-së në Prishtinë. Në seancë, paraqitësja e kërkesës ka deklaruar se familja e saj e ka përdorur pronën e pretenduar deri në vitin 1999 e cila është konfirmuar nga dëshmitarët O. Me. dhe Q. M. Pala përgjegjëse në kërkesë pranoi se paraqitësja e kërkesës dhe nëna e saj në të vërtetë kishin qëndruar në pronë deri në mars të vitit 1999, por vetëm si mysafirë".

25. Në paragrafin 22, KKPK-ja thekson se:

"Komisioni konsideron që D.J. nuk e ka shitur pronën në vitin 1973, ndonëse familja e tij kihte jetuar në atë pronë deri në vitin 1999, dhe se e njëjta ishte larguar nga prona për shkak të konfliktit"

26. Gjykata Supreme pajtohet me këtë konstatim.

27. Gjykata Supreme gjithashtu konstaton se shitja e pretenduar nga Đ. J. tek I. H. në vitin 1973 nuk është regjistruar, se kontrata e shitjes nuk është paraqitur në AKP ose në Gjykatën Supreme, dhe se nuk ka asnjë vërtetim se nënshkrimet në kontratën e pretenduar janë verifikuar nga gjykata. Lista poseduese nr. 1476 e datës 21 mars 2003 identifikon Đ.J. si posedues të pronës së kontestuar.

28. Pasi që Liljana Milosavljeviç ka poseduar pronën me familjen e saj deri në qershor të vitit 1999, Gjykata Supreme konstaton se H. Ç. nuk mund të konsiderohet të ketë qenë poseduese e pronës në të njëjtën periudhë.

29. Ndonëse masa trashëgimore e Đ. J. nuk ishte shqyrtuar dhe vendosur për trashëgimtarët e posaqërisht për Liljana Milosavljeviçin deri në vitin 2006, andaj pretendimi i H.C. është i pabazuar për të drejtën e saj të pretenduar mbi këtë pronë që është objekt i kërkesës.

30. Pretendimi se avokati i Liljana Milosavljeviç tani punon në AKP dhe është përpjekur për të siguruar që ajo të deklarohet si pronare, nuk mbështetet me fakte dhe nga Gjykata Supreme konsiderohet të jetë e parëndësishme për këtë çështje.

31. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të provave të paraqitura, Gjykata Supreme e ka të qartë se L.M. është pronare e pronës së kontestuar. Prandaj, Gjykata Supreme ka konstatuar se ankesa është e pabazuar dhe e ka konfirmuar vendimin e KKPK-së.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it